

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sesioni i ri parlamentar nis me protesta/ Kuvendi mbledhet për 1 orë, Klodiana Spahiu emërohet Ministre e Shëndetësisë, Evis Kushi vendoset nënkryetare. Opozita braktis sallën
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/sesioni-i-ri-parlamentar-nis-mes-tensioneve-protestuesit-p-ara-kuven-i513099
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:32:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8cdfefb8afa01794db18af32c438b29d5fbc9f3d04ff6a69252f315c94ff36b8
TEKSTI	db53c5084e1ddabb243873b1979b693bd50b9221d75a0ddab5fc538729ab6ab7
PAMJA	0c595c03f8c05c7ed8036d310c6e67de8cac6342cbaf75d81f31b139a80f2f5f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	959671438a218bb60d41918cac7851a281a9b5d0d88313a9129ca54e27c7430a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/959671438a218bb60d41918cac7851a281a9b5d0d88313a9129ca54e27c7430a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepen gojën

9 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

9 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

LIVE UPDATES

Sesioni i ri parlamentar nis me protesta/ Kuvendi mblidhet për 1 orë, Klodiana Spahiu emërohet Ministre e Shëndetësisë, Evis Kushi vendoset nënkryetare. Opozita braktis sallën

• Kuvendi i Shqipërisë nisi ditën e sotme në orën 17:00, punimet e Sesionit të III-të të Legjislaturës XI. • Gjatë kësaj seance, Kuvendi miratoi me 79 vota pro, Evis Kushin si nënkryetare të Kuvendit, e cila zëvendëson në këtë post Klodiana Spahiun. • Gjithashtu me 79 vota u miratua edhe shkarkimi i ish-ministres Evis Sala nga detyra e ministres së Shëndetësisë. • Po me 79 vota pro, Kuvendi miratoi dekretin e Presidentit për emërimin e Klodiana Spahiut në postin e ministres së Shëndetësisë. • I pari që mori fjalën ishte Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, i cili vuri theksin te përgjegjësia e Parlamentit për të vijuar punën në funksion të qytetarëve dhe të interesit të vendit. • Gjatë fjalës së tij, ai bëri një bilanc të objektivave të sesionit të kaluar parlamentar, duke evidentuar çështjet dhe angazhimet e Kuvendit gjatë muajve të mëparshëm. • Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi akuzoi qeverinë dhe kryeministrin Rama se po planifikon një aferë korruptive në sistemin e shëndetësisë. • Duke iu referuar deklaratave të bëra nga ish-zv.kryeministri Arben Ahmetaj, Bardhi u shpreh se qeveria Rama dhe mazhoranca po planifikojnë të përqendrojnë sistemin shëndetësor në një dorë të vetme, duke djegur në këtë mënyrë konkurrencën e lirë. • Bardhi ka ironizuar gjithashtu edhe qasjen e re të qeverisë ndaj qytetarëve përmes BESËS dhe Pranisë Besnike. • Duke iu drejtuar kolegëve socialistë, Bardhi tha se do të jetë i pari që do të votojë projektligjin që do të sjellë Rama në Kuvend, ku do të kërkojë dënimin me burg për deputetët që do të përpiqen të fusin njerëz në punë. • Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi deklaroi se shumica e ligjeve që "rrjepin" shqiptarët mbajnë vulën e PS-së. • Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Blushi u shpreh se Parlamenti duhet të shkrihet, pasi përfaqëson interesat e shqiptarëve. • Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, deklaroi se objektivi i qeverisë është mbyllja e negociatave me BE-në brenda 2027-s. • Gjatë fjalës së tij, Balla u shpreh se duhet avancuar me reformën zgjedhore, duke shtuar se kërkohet përpjekja e të gjitha forcave politike. • Më tej, ai theksoi se roli i opozitës është i pazëvendësueshëm, duke argumentuar se përmbyllja e reformës territoriale duhet të vazhdojë dhe në vitet në vijim. • Deputeti i Partisë Demokratike, Flamur Noka, ka paralajmëruar ministrin e re të Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, lidhur me kontratat koncesionare në sektorin e shëndetësisë. • Noka iu drejtua Spahiut duke i thënë se marrja e këtij posti paraqet rrezik për të ardhmen e saj.

11 artikuj për këtë temë.

5 DITE ME PARE

"Do ta firmosësh "fap-fap" atë KAYO-n e Shëndetësisë"/ Noka paralajmëron Klodiana Spahiun: Do shkosh te vendi moj e gjorë!



editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika


Plaçkaxhiu



Flamur Noka

TIRANA- Deputeti i Partisë Demokratike, Flamur Noka, ka paralajmëruar ministren e re të Shëndetësisë, Klodiana Spahi, lidhur me kontratat koncesionare në sektorin e shëndetësisë. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Noka iu drejtua Spahiut duke i thënë se marrja e këtij posti paraqet rrezik për të ardhmen e saj.

Kjo duke argumentuar se ajo mund të përballet me pasoja ligjore. Më tej Noka, përmendi rastin e ish-zv. kryeministri Arben Ahmetaj, ish-ministrit të Shëndetësisë Ilir Beqajt dhe kryebashkiakut Erion Veliajt.



Flamur Noka: Ku është ajo Klodiana? Klodiana, do ta firmosësh “fap-fap” atë KAYO-n e Shëndetësisë, do shkosh te vendi moj e gjorë. Se kështu i tha të gjithëve ky, i tha dhe Arben Ahmetajt, “firmos ‘fap-fap’, çfarë të duash, se për kokë të Zahos të përgjigjem unë.” Ku është Ahmetaj sot?

I tha kështu edhe Ilir Beqajt, “fap-fap”, dhe Vilma Nushit dhe Klod Allajbeut, “firmosja të gjithëve, se jam unë këtu.” Ky është Beqaj sot? Kështu, moj Klodiana, i tha edhe Erion Veliajt. Ku është Veliaj sot? Prit, prit...

Klodiana, ulja në atë karrige të rrezikon kokën, matu dhe refuzoj. Kemi qenë shokë shkolle dikur dhe me dhimbje të shoh një shoqen time të shkollës “fap-fap” dhe të përfundosh pas hekurave. Reflektoni sa nuk është vonë./Dosja.al

5 DITE ME PARE

Mbyllet seanca plenare/ Kuvendi emëron Klodjana Spahiun ministre të Shëndetësisë



Klodjana Spahi

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

BOTA 13 SHTATOR 2026, 09:34

Kremlini sjell në front reliktet e një princi të shekullit të 14-të

më të klikuarat

“Qepeni gojën”/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga “Taken” te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

insights

Ola Xama
Republika e 1

TIRANA- Seanca e parë plenare për sesionin e ri parlamentar sapo është mbyllur. Gjatë kësaj seance, Kuvendi miratoi me 79 vota pro, Evis Kushin si nënkryetar të Kuvendit, e cila zëvendëson në këtë post Klodiana Spahiun.

Gjithashtu me 79 vota është miratuar edhe shkarkimi i ish-ministres Evis Sala nga detyra e ministres së Shëndetësisë. Po me 79 vota pro, Kuvendi ka miratuar dekretin e Presidentit për emërimin e Klodiana Spahiut në postin e ministres së Shëndetësisë./Dosja.al

5 DITE ME PARE

Bardhi: Do votoj ligjin e Ramës që fut në burg deputetët. I kthehet Balla: Më vjen mirë koleg, votoni dhe ligjet e tjera



TIRANË- Kreu i grupit parlamentar demokrat, Gazment Bardhi, ka ironizuar qasjen e re të qeverisë ndaj qytetarëve përmes BESËS dhe Pranisë Besnike. Duke iu drejtuar kolegëve socialistë, Bardhi tha se do të jetë i pari që do të votojë projektligjin që do të sjellë Rama në Kuvend, ku do të kërkojë dënimin me burg për deputetët që do të përpiqen të fusin njerëz në punë.

“Kur Rama të sjellë në parlament ligjin që do t’ju fusë në burg nëse fusni njerëz në punë, unë do jem i pari që e votoj”, tha Bardhi.

Pas fjalës së Bardhit, ka folur kreu i grupit socialistë Taulant Balla, i cili theksoi se i vjen mirë që dëgjon se kolegët demokratë do të votojnë një projektligj të propozuar nga socialistët.

“Më vjen mirë dhe dua ta falënderoj që i paskeni ndjekur propozimet tona, përfshirë propozimin e Ramës, me angazhimin që do ta votoni, dhe të votoni të gjitha ligjet e përafrit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së”, tha Balla./Dosja.al

5 DITE ME PARE

“Shumica e ligjeve që sot po rrjepin shqiptarët mbajnë vulën tuaj”/ Blushi: Të shkrihet Parlamenti, nuk përfaqëson interesat e shqiptarëve!



euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e “shkarkoi” sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e “burrave të zinj”

Moti

Powered by tomorrow.

Tedi Blushi

TIRANA- Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi ka deklaruar ditën e sotme se shumica e ligjeve që "rrjepin" shqiptarët mbajnë vulën e PS-së. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Blushi u shpreh se Parlamenti duhet të shkrihet, pasi përfaqëson interesat e shqiptarëve.

Më tej, ai akuzoi mazhorancën se e ka kthyer Kuvendin në shtetrrrethim. Kjo duke iu referuar masave të sigurisë të vendosura.

"Doja ta nisja me një urim, që në fakt është sot urimi i shumicës dërrmuese të të gjithë shqiptarëve, që kjo legjislaturë të mbyllë sa më parë punimet, sepse ky Parlament nuk përfaqëson vullnetin e shqiptarëve. Atyre shqiptarëve që edhe sot u kemi vënë para gardhe metalikë dhe e keni kthyer Kuvendin në shtetrrrethim, të denjë vetëm për zotin Raketa që ka gjetur mirësinë të vijë sot në Kuvend dhe uroj të japë sqarime që e ka shndërruar Shqipërinë, një vend anëtar të NATO-s... Prandaj e ftoj zotin Raketa që t'i fusë edhe një raketë në mënyrë këtij Parlamenti që duhet të shkrihet. Shumica e ligjeve që sot po rrjepin shqiptarët mbajnë vulën tuaj", tha mes të tjerash Blushi./Dosja.al

5 DITE ME PARE

Evis Kushi emërohet nënkryetare e Parlamentit



Evis Kushi

TIRANA- Evis Kushi është emëruar nënkryetare e Parlamentit, ndërsa zëvendëson në këtë post Klodiana Spahiun. Ky vendim u mor gjatë seancës plenare të Kuvendit, në nisje të sesionit të ri parlamentar.

Më herët Evis Kushi ka qene edhe ministre e Arsimit, ndërsa Klodiana Spahiu ka marrë postin e Ministres se Shëndetësisë./Dosja.al

5 DITE ME PARE

"Socialistët janë kthyer në noterë të Ramës"/ Bardhi: Qeveria po përgatit KAYO-n edhe në shëndetësi



TIRANË- Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi ka akuzuar qeverinë dhe kryeministrin Rama se po planifikon një aferë korruptive në sistemin e shëndetësisë. Duke iu referuar deklaratave të bëra nga ish-zv.kryeministri Arben Ahmetaj, Bardhi u shpreh se qeveria Rama dhe mazhoranca po planifikojnë të përqendrojnë sistemin shëndetësor në një dorë të vetme, duke djegur në këtë mënyrë konkurrencën e lirë.

Bardhi u shpreh se deputetët e PS-së janë kthyer thjesht në kartonë, që ngrenë duart, sipas asaj që do kryeministri.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.